

Përshëndetje me rastin e Ditës Botërore të Standardizimit

14 Tetor 2011

Të nderuar pjesëmarrës,

Ndjehem i lumtur të jem pjesë e promovimit të Ditës Botërore të Standardeve, e cila është bërë traditë të festohet më 14 Tetor nga DPS-ja edhe në Shqipëri ashtu si në të gjithë botën.

Duke qenë pjesë e dinamikave në tregjet ndërkombëtare Shqipëria është gjithashtu pjesë aktive në procesin e standardizimit. Ne kemi sot një institucion standardizimi të ndërtuar sipas modelit evropian i cili ka vendosur bashkëpunim me institucionet kryesore homologe ndërkombëtare. Shqipëria i ka kapacitet e nevojshme për tju përgjigjur tregut vendas me standardet më të fundit evropiane dhe ndërkombëtare. Sipas të dhënave që kemi interesi i tregut shqiptar për standardet ka ardhur gjithnjë e në rritje.

Mesazhi i kësaj dite është mjaft domethënës: **“Standardet krijojnë mirëbesim në nivel global”**. Këtë mirëbesim në Shqipëri na e japin Standardet Ndërkombëtare, të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit na i mundëson si standarde shqiptare. Vëmendja e Qeverisë sonë është që të realizohet **sigurimi** i këtij mirëbesimi. Që do të thotë që produktet dhe shërbimet e ofruara të jenë ashtu siç ne i presim, pasi standardet ndërkombëtare japin qartë kërkesat thelbësore të tyre.

Sot ne kemi një nivel të lartë pritshmërie që gjërat do të punojnë në mënyrën se si duam ne. Nga produktet dhe shërbimet e realizuara sipas standardeve ndërkombëtare përfitojnë njësoj **konsumatorët, prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve** kudo që ndodhen. E rëndësishme për vendin tonë është zbatimi i këtyre standardeve në produktet dhe shërbimet tona për të inkurajuar zhvillimin ekonomik, mirëqenien, sigurinë dhe cilësinë e jetës për të gjithë.

Përdorimi i standardeve ndërkombëtare zvogëlon barrierat tregtare, promovon sigurinë, bën të mundur që produktet, shërbimet dhe sistemet të bashkëveprojnë dhe të komplementojnë njëri-tjetrin, si dhe promovon risitë në fusha të ndryshme të ekonomisë.

Gjatë 2010-2011 Qeveria është fokusuar kryesisht në kompletimin e legjislacionit në fushën e standardizimit duke e përafruar atë me legjislacionin dhe praktikën e BE-së; në adoptimin e standardeve Evropiane të harmonizuara dhe ndërkombëtare në ato fusha me interes për ekonominë tonë. Kështu mund të përmendim standardet e fushës së ndërtimit, të ushqimit, të mjeksisë, të stomatologjisë, të tekstilit, sigurinë e lodrave të fëmijëve etj. Në procesin e standardizimit në vendin tonë **punojnë në mënyrë vullnetare rreth 200 ekspertë** të fushave përkatëse, të cilët i falenderojmë dhe i ftojmë për një bashkëpunim edhe më të ngushtë për vitin 2012.

Në këtë kuadër do të inkurajoja një bashkëpunim më të ngushtë me DPS-në dhe një pjesëmarrje më aktive në procesin e standardizimit të biznesit në drejtim të prodhimit dhe shërbimeve, si ato që operojnë në tregun vendas, por kryesisht të atyre të orientuar për eksport. Të mos harrojmë që në vendet më të zhvilluara të botës këto firma mbështesin

fuqishëm organizmat kombëtare të standardizimit, sepse nëpërmjet standardeve ofrohen teknologji të reja, zhvillohen ekonomitë dhe rritet konkurueshmëria dhe cilësia e jetës.

Më lejoni edhe njëherë që me rastin e Ditës Botërore të Standardizimit, të uroj të gjitha grupet dhe individët që kontribuojnë në procesin e standardizimit në të mirë të cilësisë së prodhimit dhe shërbimit të tregut shqiptar.

Urime dhe Ju faleminderit!